



British Embassy  
Pristina

2 Korrik 2020  
Prishtinë

**Memorandum Mirëkuptimi**  
**ndërmjet**  
**Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe**  
**Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut**  
**përfaqësuar nga Ambasada Britanike**

*Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut të përfaqësuar nga Ambasada Britanike, "Palët".*

*Palët kanë të njëjtat objektiva dhe dëshirojnë të konfirmojnë bashkëpunimin në fushat e interesit të ndërsjellë. Është në interes të të gjitha palëve që përkushtimi i Kosovës ndaj qeverisjes së mirë dhe zhvillimit ekonomik të mbështetet nga struktura publike që janë transparente, profesionale dhe llogaridhënëse.*

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit është të mbështesë përpjekjet e përbashkëta për të siguruar që të emërohen udhëheqës të fortë, të pavarur dhe profesionalë të institucioneve dhe organeve publike përmes një procesi të drejtë dhe transparent të rekrutimit. Ky projekt synon të ndihmojë institucionet e Kosovës në rekrutimin e një liste të dakorduar të pozitive të larta.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Palët bien dakord për të hyrë në bashkëpunim, që ndër të tjera, do të përfshijë mbështetje për institucionet e Kosovës në mënyrë që:



- a. të përmirësohet kapaciteti i institucioneve publike për të kontribuar drejt shënimit të rezultateve në reformat sfiduese, duke mundësuar politikë-bërje më profesionale, llogaridhënëse dhe transparente, me fokus të veçantë në vlerën për para; dhe,
  - b. rivendosjen e besimit në institucionet publike duke avancuar zbatimin e proceseve të rekrutimit, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës në fuqi. Megjithatë, në terma konkretë, projekti synon të krijojë një standard të ri për procesin e rekrutimit për emërimet publike në Kosovë.
2. Komisionet e rekrutimit sigurojnë zbatimin e procedurave të parashikuara nga legjislacioni përkatës në fuqi.
  3. Një partner zbatues i përzgjedhur nga Ambasada Britanike në Prishtinë do t'i ndihmojë institucionet e Kosovës në rekrutimin e pozitave të larta të lira brenda shërbimit civil dhe institucioneve të pavarura për të ndihmuar në parandalimin e nepotizmit dhe për të forcuar transparencën, meritokracinë dhe qeverisjen e mirë.
  4. Ambasada Britanike do të angazhojë një partner të jashtëm zbatues për të ndihmuar në proceset teknike të rekrutimit për pozitat e lira të larta të identifikuar. Përveç kësaj, partneri zbatues do të mentorojë dhe këshillojë institucionet vendore dhe do të ofrojë rekomandime për komisionet e rekrutimit dhe praktikatat më të mira të rekrutimit.
  5. Në rast se situata e krijuar me COVID-19 vazhdon e tillë ose përshkallëzohet, dhe mundësitë e lëvizjes vazhdojnë të jenë të kufizuara, partneri i jashtëm zbatues do të ndihmojë proceset teknike të rekrutimit për pozitat e identifikuar nga distanca, përmes video lidhjeve nga Mbretëria e Bashkuar duke:
    - a. mentoruar dhe këshilluar komisionet e rekrutimit në përgatitjen e shpalljes,
    - b. monitoruar proceset e filtrimit të aplikacioneve,
    - c. monitoruar intervistimin e kandidatëve,
    - d. rekomanduar kandidatët e suksesshëm.

### Neni 3 Detyrimi

1. Palët duhet të bien dakord për një listë të përbashkët të pozitave të lira të larta, rekrutimi i të cilave do të mbështetet nga ky projekt. Lista e dakorduar duhet të përpilohet me institucionet ku kërkohet procesi i rekrutimit.

2. Në varësi të fondeve në dispozicion, listës së dakorduar të pozitive të lira të larta mund t'i shtohen pozita shtesë, ose largohen pozita, bazuar në kërkesën e njëjës prej Palëve dhe pëlqimin e Palës tjetër.
3. Partneri zbatues do të drejtojë dhe përditësojë vazhdimisht një faqe interneti për të informuar mediat dhe palët e interesuara për: listën e proceseve të rekrutimit të mbështetura nga projekti; përbërjen e paneleve të rekrutimit; afatet kohore të rekrutimit; rezultatet përfundimtare dhe rekomandimet e proceseve të rekrutimit; Memorandumin e Mirëkuptimit me institucionet e Kosovës; datat e trajnimit, dhe çdo ngjarje tjetër ose informata relevante që lidhen me projektin. Faqja e internetit gjithashtu do të ketë një lidhje në faqen zyrtare të institucioneve të Kosovës.
4. Kuvendi i Kosovës duhet të informojë institucionet nga lista e dakorduar (Shtojca B) për angazhimin e Ambasadës Britanike dhe të sigurojë që proceset e rekrutimit të ndërmerren dhe të monitorohen rreptësisht nga partneri zbatues.
5. Kuvendi i Kosovës zotohet që të sigurojë që projekti të zbatohet me kohë, në mënyrë transparente dhe të paanshme.
6. Kuvendi i Kosovës duhet të marrë përsipër të lehtësojë zbatimin e projektit dhe të sigurojë që partneri zbatues: është i përfshirë në fazën e rekrutimit që nga fillimi; ka qasje të plotë në proceset e rekrutimit teknik të pozicioneve të dakorduara; qasje të plotë në informacionin e domosdoshëm; dhe mbështetjen e plotë të Kuvendit si dhe institucioneve në procesin e sigurimit të ndihmës së tillë, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
7. Në rast se partneri zbatues detyrohet të punojë nga distanca për shkak të COVID-19, Kuvendi i Kosovës merr përsipër të sigurojë hapësira që plotësojnë kushtet e distancës sociale, dhe që janë të pajisura me gjithë teknologjinë e nevojshme – kompjuter, kamera dhe mikrofon, që të mundësojnë komunikimin nga distanca mes partnerit zbatues dhe komisioneve rekrutuese gjatë procesit të filtrimit të aplikacioneve dhe intervistimit të kandidatëve.
8. Pas çdo raundi të rekrutimit, partneri zbatues do të sugjerojë një listë të ngushtë të kandidatëve, e cila do t'i ofrohet për shqyrtim komisionit përkatës. Zgjedhja përfundimtare e kandidatit të suksesshëm - nga kandidatët në listën e ngushtë që i plotësojnë kriteret - do të bëhet nga institucionet relevante të Kosovës.



9. Institucionet e Kosovës zotohen të zgjedhin kandidatin më të mirë/të ranguar më së larti nga lista e ngushtë e përgatitur nga partneri zbatues.
10. Kuvendi i Kosovës zotohet që të zbatojë rekomandimet nga raporti i partnerit zbatues dhe të rifillojë proceset nëse nuk identifikohet asnjë kandidat i mirë, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
11. Ambasada Britanike në Prishtinë, në partneritet me Kuvendin e Kosovës, merr përsipër që t'ua komunikojë rezultatet e këtij procesi institucioneve relevante dhe publikut të gjerë në mënyrë transparente dhe të drejtë.
12. Sipas ligjit, komisionet rekrutuese do të emërohen me kohë nga institucionet relevante të Kosovës. Panelet do të reflektojnë diversitetin gjinor dhe mund të kenë në përbërjen e tyre OJQ nga fusha përkatëse, për të monitoruar proceset e rekrutimit.

#### **Neni 4**

#### **Monitorimi shtesë i projektit**

1. Kuvendi i Kosovës zotohet t'u japë statusin e vëzhguesit dhe qasje të plotë OJQ-ve lokale të interesuara për të monitoruar proceset e rekrutimit nëpër institucionet e synuara të Kosovës.

#### **Neni 5**

#### **Ndërprerja**

1. Palët mund të përfundojnë pjesëmarrjen e tyre në këtë marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim prej një muaji partnerit zbatues dhe Palës tjetër, në rrethanat e mëposhtme:
  - a. Dështimi për të zbatuar projektin sipas këtij Memorandumi.
  - b. Mungesa e fondeve për të vazhduar mbështetjen e këtij projekti.
  - c. Një dështim i konsiderueshëm nga partneri zbatues për të përmbushur ndonjë nga zotimet në këtë memorandum.
  - d. Forca madhore.
  - e. Kur ndodhin ndryshime të cilat, sipas mendimit të Palëve, dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme vlerën e kontributit të projektit drejt qëllimit të dëshiruar.

#### **Neni 6**

#### **Mosmarrëveshjet**

1. Çdo mosmarrëveshje eventuale ndërmjet Palëve do të zgjidhet me negociata dhe marrëveshje.

**Neni 7**  
**Kohëzgjatja**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dy Palët dhe do të zgjasë gjatë tërë mandatit të Kuvendit të Kosovës.

**Neni 8**  
**Kopjet e memorandumit**

1. Memorandumi i nënshkruar në tri kopje identike, një për secilën Palë.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky memorandum hyn në fuqi dhe zbatohet në datën në të cilën ai nënshkruhet në mënyrë të rregullt nga të dyja Palët.

**Shtojcat**

- Shtojca A    Termat e Referencës së Projektit
- Shtojca B    Lista e pozitave të lira të larta të dakorduara

**NË DËSHMI TË KËSAJ**, përfaqësuesit e autorizuar në mënyrë të rregullt të Palëve vendosin nënshkrimet e tyre më poshtë.

*Për Kuvendin e Republikës  
së Kosovës*



*Vjosa Osmani*  
*Kryetare e Kuvendit*

*Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar  
të Britanisë së Madhe dhe Irlandës  
Veriore përfaqësuar nga Ambasada  
Britanike*



*Nicholas Abbott*  
*Ambasador*

## **KUVENDI**

<b>Pozita</b>	<b>Institucioni</b>
Avokati i Popullit	Institucioni i Avokatit të Popullit
Kryesues	Komisioni Shqyrtues i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit
Komisioner	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Anëtarë	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Anëtarë	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Anëtarë	Komisioni i Pavarur për Media
Anëtarë	Radio - Televizioni i Kosovës
Anëtarë	Bordi për Ankesa - Komisioni i Pavarur për Media
Anëtarë	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Anëtarë	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
Anëtarë	Autoriteti i Pavarur i Konkurrencës
Anëtarë	Organi Shqyrtues i Prokurimit
Anëtarë	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

\* Dhe pozitat tjera të larta drejtuese sipas kërkesës së Kuvendit.